



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR KOMUNËN E GLLOGOCIT
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës së Gllogocit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ajtene Llapashtica* udhëheqës ekipi dhe *Lindita Ajeti* e *Fisnik Rudaj* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Faruk Rrahmani*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	26
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	37
Shtojca II: Letër Konfirmimi	40

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i komunës së Gllogocit për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i Çështjes

Si theksim të çështjes, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet e ekzekutuara nga ana e thesarit për paga dhe mëditje në vlerë prej 374,616€ ishin keqklasifikuar pasi që ishin paguar gabimisht nga kategoritë jo adekuate. Po ashtu, informatat e shpalosura në Pasqyrat Financiare Vjetore në lidhje me pasuritë nuk janë të plota dhe të sakta për vlerën 423,578€, duke e nënvlerësuar për këtë vlerë regjistrin e pasurive (SIMFK).

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:**Përgjigja e Kryetarit të Komunës**

Kryetari është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit e vlerëson bashkëpunimin e treguar nga menaxhmenti i lartë dhe stafi i Komunës së Gllogocit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Glogocit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Pagesat për paga dhe mëditje (paga jubilarë dhe paga sipas marrëveshjes kolektive) të ekzekutuara nga ana e thesarit me vlerë prej 374,616€ ishin të keq klasifikuara, pasi që ishin paguar gabimisht nga kategoria e Investimeve Kapitale me vlerë prej 110,400€ dhe Mallra e Shërbime me vlerë 264,216€. Si shkak i këtyre pagesave ishte mungesa e mjeteve buxhetore në kategoritë përkatëse; dhe

- Pasuritë mbi 1,000€ në PFV ishin të nënvlerësuar, pasi që katër¹ pagesa nga Investimet kapitale me vlerë prej 73,844€ nuk ishin përfshirë në regjistrin e SIMFK-së. Gjithashtu pagesat e testuara nga viti i kaluar që kishin të bënin me projektin në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës (MI) me vlerë prej 329,439€ dhe pagesën me vendim gjykatë me vlerë prej 20,295€, (që kanë qenë theksim çështje në vitin e kaluar), nuk ishin regjistruar në SIMFK, si shkak i mos ofrimit të dokumentacionit nga ana e MI-së. Vlen të theksohet se Komuna në vitin 2019 ka regjistruar në SIMFK projektin në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe projektin “Asfaltimi i rrugës në Bincë, lagja Topalli dhe Kiqina”, por që në PFV-të e vitit 2018 ky ndryshim nuk ishte reflektuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është

¹ Pagesa për “Asfaltimi i rrugës në Baicë, lagja Topalli dhe Kiqina” me vlerë 30,777€, e datës 29.11.2018; Pagesa për “Hartimi i hartave Zonale” me vlerë 20,000€, e datës 11.12.2018; Pagesa për Mirëmbajtja e kanalizimeve dhe gropave septike në komunën e Drenasit” me vlerë 12,519€, e datës 18.12.2018 dhe Pagesa për “Furnizim me gjeneratorë, pompë uji, antifriz për nxemje dhe pajisje tjera” me vlerë 10,547€ e datës 12.12.2018.

relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike dhe 02/2013 për menaxhimin e pasurive;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportimin e obligimeve të papaguara;
- Raportet e progresit për projektet kapitale; dhe
- Pyetësin e vet-vlerësimit.

PFV-të janë përgatitur në pajtueshmëri me formatin për raportim, si dhe janë nënshkruar dhe dorëzuar brenda afatit ligjor në MF.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi B1 Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime konkrete duhet të ndërmerren për të eliminuar gabimet në planifikimin/buxhetimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre. Gjithashtu, informatat lidhur me shpalosjen e pasurive duhet të jenë të plota me qëllim të prezantimit të tyre të saktë në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, llogaritë e arkëtueshme, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Glllogocit kishte shpenzuar 91% të buxhetit final për vitin 2018 që nënkupton një realizim të mirë në nivel të përgjithshëm. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë nevojiten mekanizma shtesë për të reaguar në arkëtimin e tyre dhe mbledhjen e të arkëtueshmeve në masë më të madhe.

Gjithashtu, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar: keq klasifikimin e shpenzimeve, angazhimin e një numri të lartë të punonjësve me marrëveshje të veçanta, pagesat me vendime gjyqësore dhe vonesat për përfundimin e projekteve kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	14,477,300	15,170,891	13,901,613	12,483,647	11,609,435
Granti i Qeverisë -Buxheti	13,146,523	13,005,427	12,498,679	11,237,166	10,811,810
Të bartura nga viti paraprak ³	1,166,676	1,463,177	996,865	814,618	634,179
Të hyrat vetjake ⁴	-	507,987	373,453	425,819	142,775
Donacionet e brendshme	-	8,759	5,980	6,044	10,671
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	10,000
Huamarrjet	164,101	185,541	26,636	-	-

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 693,591€. Nga granti i Qeverisë buxheti kishte pasur reduktim prej 141,096€, ndërsa rritjet ishin rezultat i donacioneve të brendshme në vlerë prej 8,759€, të hyrave të vitit dhe të bartura nga viti paraprak 804,488€ si dhe me vendime të Qeverisë për huamarrjen për 21,440€.

Në vitin 2018, komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final, ngjashëm me vitin 2017. Procesi i menaxhimit të buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm, mirëpo te investimet kapitale rreth 70% e buxhetit është realizuar në tre mujorin e fund vitit, kryesisht për shkak të inicimit me vonesë të procedurave të prokurimit.

Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	14,477,300	15,170,891	13,901,613	12,483,647	11,609,435
Pagat dhe Mëditjet	8,230,027	8,088,931	8,088,931	7,762,216	7,864,833
Mallrat dhe Shërbimet	1,482,000	1,534,866	1,281,894	966,169	949,262
Shërbimet komunale	157,860	157,861	150,368	205,586	157,267
Subvencionet dhe Transferet	212,063	256,471	232,616	171,737	234,410
Investimet Kapitale	4,395,350	5,132,762	4,147,803	3,377,939	2,403,663

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 141,096€ me vendim të qeverisë nr. 07/80;
- Buxheti për mallra dhe shërbime, ishte rritur për 52,866€. Rritja ka ndodhur nga të hyrat vetjake për 30,000€, të hyrat e bartura 12,733€ si dhe nga huamarrjet 10,133€, përderisa te shërbimet komunale nuk kemi ndryshim;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 44,408€ nga të hyrat e bartura; dhe
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 737,412€. Rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura për 450,846€, të hyrat vetjake 266,501€, donatorët e brendshëm 8,759€ si dhe nga huamarrja 11,306€.

Çështja B2⁵ - Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategori dhe kode ekonomike**Gjetja**

Ligji Nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike. Ne kemi identifikuar se gjatë këtij viti kishte pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate si:

- Shpenzimet për subvencione në vlerë prej 34,120€⁶, që kishin të bënin me marrëveshjen e bashkëfinancimit me Caritas Kosova për ofrim të shërbimeve "Përkujdesja shëndetësore shtëpiake dhe ambulatore në Drenas Home Care I", dhe pagesa me vlerë prej 4,930€ në lidhje me kontratën "Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit" ishin paguar gabimisht nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve;
- Shpenzimet për Mallra dhe Shërbime me vlerë 12,000€ që kishin të bënin me "Mirëmbajtjen e parqeve dhe gjelbërimit të qytetit të Drenasit" ishin paguar gabimisht nga kategoria e Investimeve Kapitale; dhe
- Shpenzimet në vlerë prej 26,452€ për ndërtimin e shtëpive për skamnor ishin keq kodifikuar pasi ishin paguar nga kodi ekonomik - mirëmbajtja investive përderisa, kjo pagesë i takon kodit ekonomik - transfere kapitale për entitete jopublike.

Kjo ka ndodhur si shkak i mungesës së mjeteve financiare dhe mos planifikimit të mjeteve nga kategoritë përkatëse.

Rreziku

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës, si dhe në mos realizimin e të gjitha projekteve kapitale të synuara për arritjen e objektivave të komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen në pajtim me ligjin e buxhetit dhe kodeve ekonomike të përcaktuara sipas planit kontabël për kategori.

⁵ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

⁶ Pagesa datë 06.06.2018, vlerë 8,530€; Pagesa datë 23.08.2018, vlerë 17,060€ dhe Pagesa datë 11.12.2018, vlerë 8,530€.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna për vitin 2018 ishin në vlerë prej 1,310,555€. Prej tyre donacionet ishin me vlerë 5,180€.

Të hyrat e arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës ishin, nga gjobat në trafik 332,088€, gjobat nga gjykatat 36,500€ dhe nga agjencioni i pyjeve 6€. Të hyrat kanë të bëjnë kryesisht me arkëtimet nga të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Pranimet ⁷	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,166,676	1,166,676	1,305,375	1,073,197	1,090,793

Komuna kishte performancë të mirë në realizimin e të të hyrave, duke i tejkaluar planifikimet për 12%. Kjo rritje kishte ardhur nga fakti që këtë vit janë arkëtuar me përmbarues të hyrat nga qiraja për parkun e biznesit me vlerë prej 285,895€. Krahësuar me vitin e kaluar të hyrat janë rritur për 22%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final dhe shpenzimet për pagat dhe mëditjet ishin 8,088,931€. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Financave (MF).

⁷ Të hyrat pa donacione, pa gjoba, dënime të policisë.

Çështja A1 - Dobësi në udhëheqjen e procedurave të rekrutimit**Gjetja**

Në procesin e konkursit të rekrutimit për “Zyrtar për prodhimtari bujqësore”, është kërkuar që kandidati duhet të ketë dy vjet përvojë pune profesionale. Gjatë testimit të lëndës identifikua se i përzgjedhuri nuk e kishte plotësuar këtë kriter pasi përvojë profesionale të dokumentuar kishte një vjet e dy muaj.

Komisioni vlerësues e kishte pranuar si përvojë edhe përvojën jo në profesionin e kërkuar, si administratore në zyrë. Vlen të ceket se e njëjta kishte marrëveshje me shërbime të veçanta me komunën për pozitën “Zyrtare për bujqësi” prej 03.04.2017 deri me 29.06.2018 (dy kontrata). Dobësitë e identifikuar janë shkaktuar nga neglizhenca dhe kompetenca e komisionit për të vlerësuar drejt kriteret e vendosura në konkurs.

Rreziku

Mos përmbushja e kriterëve gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve rritë rrezikun që të jetë angazhuar personi jo meritator për pozitën e kërkuar.

Rekomandimi A1 Kryetari, duhet të sigurojë se në procesin e rekrutimit ka emëruar komisione profesionale me qëllim që gjatë procesit të vlerësimit të respektohen plotësisht kriteret e kërkuara në mënyrë që të sigurohet që vetëm kandidatët meritator kanë fituar pozitat e punës.

Çështja B3 – Marrëveshjet për shërbime të veçanta (MSHV)

Gjetja Neni 12 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil përcakton se emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj duhet të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” (MSHV) për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2018 kishte të angazhuar 23 punonjës me MSHV⁸, ku 17 prej tyre ju kishte vazhduar kontrata për herë të dytë edhe për pesë muaj tjerë. Ne kemi vërejtur se me rastin e vazhdimin të kontratave në tri raste nuk janë përdorë procedura të thjeshtësuara të rekrutimit.

Arsyeja pse janë lidhur këto kontrata ishte mungesa e mjeteve të planifikuara për këto pozita, dhe mundësia më e lehtë e angazhimit përkundër faktit se këto shërbime ishin kryesisht për pozita të rregullta.

Rreziku Angazhimi i stafit me MSHV për pozita të rregullta, dhe vazhdimi i tyre pa procedura të thjeshtësuara kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që cilësia e shërbimeve të pranuar të mos jenë në përputhje me nevojat.

Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për këtë kategori në vitin 2018 ishte 1,692,727€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,432,262€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet komunale, shpenzimet e derivateve dhe lëndët tjera për ngrohje, mirëmbajtje të objekteve, shpenzime kontraktuese tjera, etj.

⁸ 13 nga MSHV vazhdonin marrëveshjet nga viti 2017, 10 ishin të vitit 2018.

Çështja A2 – Dobësitë e evidentuara te pagesat me vendime gjyqësore

E gjetura Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike në nenin 4 dhe 21 përcakton se për cilat shpenzime aplikohet procesi i prokurimit publik. Po ashtu, për kryerjen dhe përfundimin e punëve në teren nevojitet mbikëqyrja nga organet përkatëse dhe menaxheri i projektit.

Te pagesa e ekzekutuar nga Thesari me vendim të përmbaruesit me vlerë prej 17,043€ për projektin “Renovimi i kulmit të SHFMU “Rilindja” në Dritan kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Për këtë shpenzim (pagesë) nuk janë zhvilluar procedura të prokurimit rrjedhimisht s’ka pasur kontratë; dhe
- Nuk është formuar ndonjë komision për mbikëqyrjen e punëve e as për pranim të punëve të përfunduara.

Këto kanë qenë arsyet që nuk ishte paguar në mënyrë të rregullt obligimi, nga Komuna. Përkundër mangësive faktike përmbaruesi ka lëshuar urdhër mbi pagesën e kreditorit⁹. Vlen të ceket se as fatura dhe as propozimi për përmbarim nuk ka pasur protokoll që dëshmohet pranimi i dokumentacionit në arkivin e Komunës.

Kryetari i komunës bazuar në rrjedhën e këtij procesi ka ngrit padi ndaj ish drejtorit në Drejtorin e Arsimit të Komunës, për këtë dhe çështje të tjera.

Rreziku Krijimi i shpenzimeve dhe shmangia e procedurave të prokurimit për raste emergjente, rritë rrezikun e dëmtimit të buxhetit të Komunës.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë me rastin e pranimit të propozimit për përmbarim, në rastet kur ka mos pajtime lënda të procedohet në gjykatë, njëherit duhet siguruar që për të gjitha rastet e kryerjes së punëve të përdoren procedurat e nevojshme të prokurimit si dhe të gjitha dokumentet duhet protokolluar pa përjashtim.

⁹ Urdhëri është lëshuar mbi bazën e faturës së OE, prezantimit të situacionit dhe fotografive në teren

Çështja A3 - Vonesa në liferimin e mallrave**Gjetja**

Në kushtet e veçanta të kontratave definohet afati i liferimit të mallit. Kemi vërejtur se në dy kontrata (tri pagesa) kishte vonesa në liferim të mallrave dhe nuk janë aplikuar ndëshkimet të përcaktuara në kontratë:

- Te pagesa për “Furnizim me ushqim për nevojat e QEAP Ardhmëria Drenas dhe Komoran” në vlerë 5,345€ kishte vonesa në pranimin e mallit deri në 70 ditë, përtej afatit të përcaktuar 3 ditor me kontratë; dhe
- Në dy pagesa në vlerë prej 126€ për “Furnizim me material shpenzues zyrtar për nevojat e institucioneve komunale” kishte vonesa në pranimin e mallit deri në 120 ditë, përtej afatit të përcaktuar 8 ditor me kontratë.

Arsyeja e vonesave ishte menaxhimi jo i duhur i kërkesave për furnizim, pasi që përkundër që kishte stoqe kërkesat bëheshin shumë më përpara, dhe më pastaj nuk kishte insistim që mallrat të liferohen sipas kushteve të kontratës.

Rreziku

Vonesat në liferimin e mallit sipas afateve të kontraktuara, rrisin rrezikun që të paraqesin pengesë për zhvillimin e aktiviteteve operationale të komunës.

Rekomandimi A3 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, dhe në rastet e vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

Çështja A4 - Dobësi në procesin e vlerësimit dhe menaxhimin e kontratave

Gjetja Blerjet përmes prokurimit publik duhet të zhvillohen në pajtim me kërkesat e LPP-së, duke respektuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, përmes dëshmive përkatëse.

Në dosjen e tenderit “Intervenime Emergjente” me vlerë 9,060€, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional ishte kërkuar që stafi profesional i përfshirë në projekt (Inxhinieri i Projektit), të kishte të dëshmuar përvojën e punës minimum dy vjet. OE fitues kishte siguruar vetëm marrëveshjen paraprake për angazhim, CV-në dhe diplomën, mirëpo jo edhe dëshminë për përvojën e punës.

Gjithashtu, menaxher i kontratës ishte caktuar njëri nga anëtarët e komisionit që kishte bërë vlerësimin e ofertave për këtë projekt, që është në kundërshtim me nenin 62.3 pika 7 e Udhëzuesit operativ të prokurimit publik.

Si shkak i mos kompetencës, komisioni ka vlerësuar pranueshmërinë e përvojës vetëm përmes CV-së. Caktimi i njërit anëtar të vlerësimit si menaxher të kontratës kishte ndodhë për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm.

Rreziku Shpërblimi me kontratë pa u përmbushur kriteret mund të rezultojë me përzgjedhje të ofertuesve të pa përgjegjshëm duke shkelur parimin e trajtimit të barabartë. Po ashtu, angazhimi i zyrtarëve të njëjtë në vlerësimin e ofertave dhe në menaxhimin e projektit rrit rrezikun e konfliktit të interesit dhe mund të ndikojë negativisht në menaxhimin financiar dhe operativ të projektit.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se do të respektohen kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë. Gjithashtu duhet siguruar që ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në aktivitetet e prokurimit të parandalojë mundësinë e konfliktit të interesit.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 256,471€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 232,616€. Subvencionet ndahen për entitete jopublike dhe kryesisht janë shpenzuar për të përkrahur sektorin e bujqësisë, kulturës, arsimit dhe shëndetësisë në kuadër të Komunës.

Çështja C1 – Mangësi në menaxhimin e subvencioneve

E gjetura

Neni (7) i rregullores për subvencione të Komunës parasheh që, komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve e emëron Kryetari i Komunës, dhe përbërja e tij duhet të jetë prej pesë anëtarëve. Po ashtu, neni 13 i Rregullores për subvencione, parasheh që për realizimin e subvencionit duhet të lidhet një marrëveshje mes përfituesit dhe Komunës me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrat mes dy palëve. Ne kemi vërejtur se:

- Te procesi i shpërndarjes së subvencioneve, në bazë të thirrjes për aplikim për sera 50m² dhe për koshere bletësh, aktvendimet e formimit të komisionit për shqyrtimin e aplikuesve i kishte marrë drejtori i drejtorisë së bujqësisë dhe komisioni përbëhej prej tre anëtarëve. Gjithashtu këto komisione me rastin e shqyrtimit të aplikantëve nuk kanë mbajtur procesverbale siq e kërkon neni 8 i rregullores, por vetëm shënime në një fletore me rastin e vizitave në teren; dhe
- Në tri pagesa të testuara me vlerë 34,500¹⁰€ që kishin të bënin me procesin e thirrjes publike për aplikim në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, marrëveshjet me përfituesit janë hartuar me vonesë, pas pagesës së mjetëve. Te mbështetja financiare prej 3,000€ kemi vërejtur që përfituesi nuk kishte raportuar sipas nenit 2.2 të marrëveshjes. Për më tepër shumë prej 710€ përfituesi nuk kishte arritur të dëshmojë me fatura.

Mangësitë e tilla kanë ndodhur për shkak të mungesës së stafit dhe numrit të madh të përfituesve si dhe kontrolleve të dobëta në menaxhimin e subvencioneve.

Rreziku

Anashkalimi i rregullores së subvencioneve për caktimin e komisionit, mbajtjen e procesverbalit dhe hartimin e marrëveshjes me përfituesin rrisin rrezikun për përzgjedhjen e përfituesve jo meritore.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi të bëhet në harmoni të plotë me rregulloren për subvencione dhe çdo shmangie nga kjo rregullore të analizohet dhe gabimet të korrigjohen. Marrëveshjet të hartohen para shpërndarjes së mjetëve të përfituesit, dhe të rriten kontrollet monitoruese pas shpërndarjes së subvencioneve.

¹⁰ Procesit të thirrjes publike për aplikim në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për tri pagesa me vlerë 30,000€, 3,000€ dhe 1,500€

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,132,762€. Prej tyre në 2018 ishin shpenzuar 4,147,803€. Investimet kanë të bëjnë kryesisht me rregullim të infrastrukturës, ndërtim të shkollave, shpronësime, pajisje dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja A5 – Parregullsitë në procesin e pagesave

Gjetja

Sipas kushteve të veçanta të kontratave përcaktohet afati që kontrata hyn në fuqi, 3 ditë pas nënshkrimit të palëve. Për tri kontratat e mëposhtme rreth 45% e pagesave ishin kryer brenda tri ditëve pas nënshkrimit të kontratës: Ne kemi vërejtur se:

- Te kontrata “Asfaltimi i rrugës në qytezën e Komoranit në fshatin Korroticë e Ulët” me vlerë prej 59,620€, ishte realizuar pagesa prej 28,500€, dy ditë pas nënshkrimit të kontratës (data e kontratës 20.12.2018), kurse urdhër blerja është proceduar ende pa u lidhur kontrata me datë 14.12.2018;
- Te kontrata “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Abri e Epërme” me vlerë prej 76,295€, ishte realizuar pagesa prej 38,000€ dy ditë pas nënshkrimit të kontratës, (data e kontratës 20.12.2018) kurse urdhër blerja është proceduar ende pa u lidhur kontrata me datën 14.12.2018; dhe
- Te kontrata “Bashkëfinancimi i projekteve me donator të jashtëm, faza e dyte - ndërtimi i kolektorëve Drenas - Skenderaj” me vlerë prej 61,607€ ishte realizuar, pagesa në vlerë prej 23,142€, tri ditë pas nënshkrimit të kontratës.

Sipas zyrtarëve shkak i procedimit të urdhër blerjeve dhe ekzekutimit të këtyre pagesave, ka qenë mbyllja e pagesave për vitin aktual fiskal dhe shfrytëzimi i buxhetit.

Rreziku

Pagesat e tilla rrisin rrezikun që punët e papërfunduar të jenë paguar, përderisa procedimi i urdhër blerjes para nënshkrimit të kontratës rrezikon që në rast të dështimit të nënshkrimit të kontratës të krijohen obligime fiktive në sistem.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të siguroj se aplikohen kushtet e kontratës, dhe procedimi i urdhër blerjeve bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës.

Çështja B4 - Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe mangësi në planifikim**Gjetja**

Sipas nenit (20) pika 10 i Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (UOPP) kërkohet që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten. Ne kemi vërejtur se:

- Në pesë¹¹ projekte për punë komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por kishte zhvilluar procedurat e prokurimit vetëm me para masën dhe para llogarinë. Po ashtu, në këto projekte janë evidentuar vonesa në realizimin e tyre, mos azhurnim i planeve për menaxhimin e kontratës, si dhe një rast nuk ka raport nga menaxheri i kontratës; dhe
- Prej gjithsej 99 kontratave për punë, në 17 prej tyre janë lidhur aneks kontrata në vlerë prej 147,098€ për punë të paplanifikuara dhe punë shtesë të cilat kanë dalë gjatë realizimit të kontratave. Arsytet e numrit të lartë të aneks kontratave janë: zgjatja e rrugëve me kërkesë të banorëve lokal dhe pengesat lidhur me problemet pronësore; devijimet e punëve gjatë ekzekutimit të projekteve në teren të cilat kanë rezultuar edhe me kosto shtesë që kanë rrjedhë si pasojë e mungesës së projekteve ekzekutuese.

Vonesat janë shkaktuar kryesisht nga mungesa e projekteve ekzekutuese, pengesat e paparashikuara gjatë punimeve, si problemet me: banorët lokal, kushteve atmosferike, specifikat e punëve etj.

Rreziku

Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin e profesional ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të forcoj kontrollët për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UOPP për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Proceset e prokurimit për projekte ekzekutive duhet të kryhen në fillim në mënyrë që t'i paraprijnë inicimit të prokurimit të projekteve tjera për punë.

¹¹ Projekti "Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Dobroshec, Gllanasellë, Likoshan dhe Gradicë"; "Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Sankoc, Kizhnarekë dhe Komoran"; "Asfaltimi i rrugës në F.Korroticë e Ulët"; "Infrastruktura me kubëza betoni në Drenas" dhe "Ndërtimi i stadionit të qytetit fazë e dytë".

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja A6 – Pagesat e ekzekutuara nga Thesari për vendimet Gjyqësore

Gjetja Neni (39) i LMFPF përcakton ZKF-në e organizatës buxhetore përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimi të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Ne kemi identifikuar se Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 475,654€, prej tyre borxhi kryesor ishte 388,564€ dhe shpenzimet procedurale të gjykatës (përmbartimet) ishin 87,090€. Po ashtu, kjo formë e pagesave nga thesari ka ndikuar në keq klasifikimin e shpenzimeve, marrjen e mjeteve nga kategoritë ekonomike jo adekuate (shih theksimi i çështjes).

Pagesat kryesisht kishin të bëjnë me pagesat e dala nga marrëveshja kolektive për pagesë të tri pagave jubilarë të punonjësve të arsimit, tri paga përcjellëse me rastin e pensionimi, paga të pa paguara si dhe borxhe ndaj furnitorëve si shkak i mungesës së mjeteve buxhetore nga mos shlyerja me kohë e obligimeve ndaj furnitorëve.

Rreziku Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbartimit ndikon direkt në rritjen e kostos për Komunën dhe njëherit edhe në keq klasifikimin e shpenzimeve.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu, obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPF, për të shmangur pagesat me vendime përmbartimore dhe me kosto më të lartë.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV-të 2018 ishte 502,143,762€ ndërsa vlera e pasurisë jo kapitale ishte 348,810€. Stoqet në fund vit ishin 3,793€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore,

procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja B5 – Dobësitë në menaxhimin e pasurive

Gjetja Sipas nenit (6.3) të rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë, Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “E-pasuria”.

Për raportimin e pasurisë jo kapitale në PFV komuna kishte shfrytëzuar raportet/regjistrat e komisioneve të inventarizimit të pasurive në fund vit, pasi programi i E-Pasurisë nuk ishte funksionalizuar. Ishin bërë përpjekje, Arsimi dhe Shëndetësia kishin filluar regjistrimin në programin e E-Pasurisë në vitin 2018, përderisa administrata në vitin 2019, megjithatë nga testet tona është verifikuar se gjashtë pagesa me vlerë 6,091€ nuk ishin regjistruar, as në programin e E-Pasurisë e as në regjistrat e Excel-it në fund vit. Dobësitë e identifikuar të pasuria ishin si shkak i mungesës së stafit, pozitive vakante për një kohë të gjatë.

Rreziku Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë, si dhe mos regjistrimi i pasurisë jokapitale në E-Pasuri, ndikon që pasuria e Komunës të jetë e nënvlerësuar dhe shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që e posedon komuna duke rezultuar në prezantimin jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi B5 Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive duke mos e nënvlerësuar pasurinë në PFV, gjithashtu të sigurojë evidentimin e pasurisë jokapitale në sistemin e E-Pasurisë.

3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme në PFV në fund të vitit ishin 3,262,780€. Strukturën e të arkëtueshmeve e përbëjnë: tatimi në pronë, taksat në biznes, qiratë dhe lejet e ndërtimit. Pjesëmarrjen më të madhe në këtë strukturë e kanë të arkëtueshmet nga taksat në biznes 1,656,510€ dhe tatimi në pronë në vlerë 1,433,820€.

Çështja B6 – Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e të arkëtueshmeve pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Nga viti paraprak ato janë rritur për 829,240€ apo rreth 34%. Kemi vërejtur se:

- Rritja më e madhe e të arkëtueshmeve ishte te taksat në biznes që krahasuar me vitin paraprak ato ishin rritur për 653,470€, dhe te tatimi në pronë për 79,620€. Komuna për borxhet e taksave kishte dërguar disa vërejtje dhe lëndë te përmbaruesi, përderisa të tatimi në pronë nuk kishte dërguar ndonjë vërejtje për pagesë apo te përmbaruesi si një mundësi për mbledhjen e të arkëtueshmeve, pasi që sipas zyrtarëve janë në pritje të aprovimit të ligjit të ri i cili parasheh mbledhjen e borxheve me përmbarues; dhe
- Te shpalosja e saldove të arkëtueshmeve të prezantuara në PVF vërehet mbivlerësim te taksat në biznes për 6,585€, te qiratë për 220€ dhe lejet e ndërtimit për 256€. Problemet e identifikuar te bartja e saldove kryesisht kanë të bëjnë me programin me të cilin menaxhohen taksat në biznes, neglizhencën dhe kompetencën e zyrtarëve që menaxhojnë me këto të dhëna.

Rreziku

Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e të arkëtueshmeve rezulton me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës. Mos raportimi i plotë i llogarive të arkëtueshme si dhe menaxhimi i të dhënave në Excel ka për rrezik saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e të arkëtueshme, duke siguruar procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimin të tyre. Posedimi i një plani dhe programi operativ dhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve do ta rrisin nivelin e mbledhjes së borxheve.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 52,850€ përafërsisht obligimet ishin 41% më të larta se vitin paraprak (obligimet e vitit 2017 ishin 37,310€). Gjithashtu detyrimet kontingjente të paraqitura në PFV ishin 143,070€ e që janë rritur për 87% nga viti 2017 (76,630€),¹² megjithatë nga testimi i një detyrimi kontingjent në vlerë prej 29,448€, të paraqitur nga

¹² Rritja është e lartë për arsye se vitin paraprak janë paraqitur vetëm detyrimet e vitit, nuk janë bartur nga vitet paraprake.

komuna në pasqyrat vjetore financiare, kemi vërejtur që i njëjti detyrim ishte i paguar nga Thesari¹³ e megjithatë figuronte në listë duke e mbivlerësuar këtë llogari. Këto detyrime mund të paraqesin komplikime buxhetore për vitin vijues.

Çështja B7 - Vonesat në pagesa si dhe dobësitë në raportimin e obligimeve

Gjetja Sipas Rregullës financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të OB-ve, (neni 5) pika 3 thekson se “Raporti mujor i obligimeve të papaguara”, duhet të përfshijë gjendjen e obligimeve të periudhës raportuese, përfshirë këtu të gjitha obligimet, pa marrë parasysh se në cilën periudhë kanë ndodhur”. Po ashtu, OB duhet që çdo faturë të vlefshme për pagesë, ta paguajnë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e pranimit të faturës. Ne kemi vërejtur se:

Komuna nuk kishte raportuar për obligimet e papaguara të muajit janar dhe shkurt të vitit 2018. Gjithashtu kemi identifikuar që Komuna, me rastin e paraqitjes së obligimeve të papaguara në MF nuk kishte përfshi në raporte edhe obligimet e muajit përkatës, kjo është vërtetuar nga pesë mostrat e testuara në vlerë 6,607€. Mostrat e njëjta kanë vonesa në pagesat e faturave prej 40 deri në 210 ditë.

Mos përcjellja e obligimeve dhe detyrimeve në nivelin e duhur, ka ardhur si rezultat i bashkëpunimit të dobët mes drejtorive, por edhe mungesës së ZKF-së. Kurse vonesat në pagesën e faturave kanë rrjedhur kryesisht si shkak i mungesës së buxhetit.

Rreziku Kontrollat e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve mujore, paraqesin pasqyrim jo të drejtë të obligimeve, ndërsa vonesat në pagesa krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues si dhe mundësinë e ekzekutimeve direkt nga Thesari.

Rekomandimi B7 Kryetari, duhet të sigurojë komunikim efektiv në mes të drejtorive, për të mundësuar një raportim të plotë të obligimeve siç edhe kërkohet me rregullën financiare 02/2013. Po ashtu duhet siguruar kontrole në ekzekutimin e pagesave, për të eliminuar vonesat në pagesën e faturave.

¹³ Pagesa me datë 29.11.2018 përmes përmblyesit privat.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Procesi për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të vitit paraprak, mungesa e proceseve monitoruese për menaxhimin e rrezikut dhe kontrolle të dobëta mbi shpenzimet dhe të hyrat janë disa nga dobësitë e identifikuara në qeverisje.

Komuna me kohë kishte përmbushë kërkesën për dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit në MF. Njëra nga çështjet e pyetësorit e cila kishte të bënte me proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave, konsiderohet si e vendosur nga ana e komunës mirëpo, nuk na janë ofruar dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve.

Komuna posedon këto plane: Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban i Glllogocit (2008-2020), përderisa është në hartim e sipër të Hartës Zonale.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - drejtori dhe një auditor. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë tetë auditime, dhe tri auditime me kërkesë të veçantë të cilat edhe ishin realizuar.

Komiteti i auditimit ishte formuar me datë 24.04.2018, ishte funksional dhe kishte mbajtur katër takime të rregullta ku janë shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm duke i dhënë mbështetje NjAB-së me zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e menaxhmentit. Nga raportet e monitorimit vërehet se ka një progres të mirë në zbatimin e rekomandimeve dhe në këtë proces nuk kishte munguar edhe mbështetja e komitetit të auditimit.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja C2 – Dobësi në kontrollet menaxheriale

Gjetja Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë, si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve.

Përkundër që regjistri i rreziqeve ishte hartuar, ne nuk kemi vërejtur se ai po menaxhohet dhe monitorohet në periudha tremujore për të parandaluar dhe zbutur rreziqet siç e kërkojnë rregullat e MFK-së.

Rreziku Kërkesat jo të qarta të llogaridhënies dhe raportimit financiar duhet të forcohen për të përkrahur efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, në mënyrë që informacioni financiar të jetë i plotë në funksion që ta përkrahë vendimmarrjen e menaxhmentit.

Rekomandimi C2 Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të komunës ka rezultuar me 21 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimeve ku kishte paraqitur mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i ZKA-së, ishte diskutuar në Asamblenë Komunale në mbledhjen e datës 27.06.2018.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, tetë (8) rekomandime janë zbatuar; shtatë (7) rekomandime ishin të përsëritura; dy (2) rekomandime ishin pjesërisht të përsëritura dhe katër (4) rekomandime ishin të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari, duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit, si dhe të çështjeve kyçe. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar gabimet në planifikimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre të drejtë në PFV. Po ashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandim i përsëritur Ref: B1
2	Procesi i buxhetit	Kryetari, duhet të siguroj që performanca buxhetore monitorohet vazhdimisht dhe në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson pengesat dhe vështirësitë për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet fillestare të buxhetit janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. Po ashtu, Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike të ndara për kategori përkatëse varësisht përfitimeve.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandim i përsëritur Ref: B2
3	Të hyrat	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin dhe raportimin e të hyrave për të siguruar se ato inkasohen, deponohen, evidentohen dhe raportohen sipas kërkesave ligjore, përfshirë kushtet e përcaktuara më kontratë. Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se lidhja e kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës mbështetet në bazë ligjore, njëkohësisht, të rishqyrtoj kontratën dhe të siguroj se janë ndjekur të gjitha procedurat e	Përkundër që nuk është zbatuar ky rekomandim është i përfshirë te rekomandimi B6.	Rekomandim i mbyllur i pazbatuar

		përzgjedhjes sipas rregullores përkatëse dhe vendimit të Kuvendit Komunal.		
4	Pagat dhe shtesat	Kryetari, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe me Udhëheqësin e QKMF-së duhet të sigurojnë se janë vendosur kontrollet adekuate, në mënyrë që të shqyrtojnë dukurinë e identifikuar dhe të aplikojnë kontrolle monitoruese ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive-ndërrimeve të natës. Ndonëse, pas këshillave tona gjatë auditimit, komuna ka filluar të ndërmarrë masa, dhe zbatimi i rekomandimit do të rishikohet në auditimin vijues.	Nuk kemi identifikuar r çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
5	Menaxhimi i personelit	Kryetari, duhet të shqyrtojnë rastet e identifikuar dhe të marrin masat e nevojshme për të siguruar se me rastin e rekrutimit të punëtorëve respektohen dispozitat ligjore dhe pozitat e rregullta mbulohen nga të punësuar të rregullt dhe meritor.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandim i përsëritur Ref: B3
6	Mallrat dhe shërbi met	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që të evitohen vonesat në procedurat e prokurimit dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde për realizimin e tyre. Gjithashtu, duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave.	Nuk kemi identifikuar r çështje të ngjashme	Rekomandim i zbatuar
7	Mallrat dhe shërbi met	Kryetari, duhet të sigurojë se kërkesat e prokurimit duhet të përmblihen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuese për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta dhe përdorimin e procedurave minimale dhe kuotimin. Kjo duhet të bëhet duke planifikuar me kohë dhe duke fokusuar në një proces efektiv të prokurimit që siguron vlerën për parën e shpenzuar. Po ashtu kryetari duhet të sigurojë ndarjen e drejtë të detyrave si kriter për kontrolle më të mira.	Nuk kemi identifikuar r çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
8	Subvencionet dhe	Kryetari, duhet të sigurojë se është bërë plotësim ndryshimi i rregullores për menaxhimin e subvencioneve për të përcaktuar limitin buxhetor për aprovimin e subvencioneve nga ana e kryetarit, si dhe të sigurojë se	Kryetari kishte marrë një vendim ku përcaktohe	Rekomandim pjesërisht i përsëritur – Ref:C1

	transferet	subvencionimi bëhet në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara me rregullore.	n limitet për subvencionim. Megjithatë, ende kishte dobësi në aplikimin e rregullores.	
9	Investimet me Kapital e	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet në proceset e planifikimit dhe menaxhimit të projekteve për të siguruar se fillimisht janë hartuar projektet ekzekutive për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë, e më pas të sigurojë një monitorim të rregullt të tyre për të siguruar se punët realizohen në përputhje me kushtet e kontraktuara. Në rastet kur paraqitet nevoja për punë shtesë në raport me ato të kontraktuara, atëherë kontraktimi i tyre duhet të bëhet përmes procedurave të hapura të prokurimit.	Nuk janë marrë veprime.	Rekomandim i përsëritur Ref: B4
10	Investimet me Kapital e	Kryetari, duhet të siguroj kontrollet tek autorizimi i pagesave për të siguruar pavarësinë e plotë gjatë autorizimit të pagesave. Në rast të mungesës së stafit të mjaftueshëm të shqyrtohet edhe mundësia e angazhimit të stafit jashtë njësive kërkuese për menaxhimin e kontratave. Më tutje, planet e menaxhimit të kontratave duhet të azhurnohen me kohë në bazë të kryerjes së punëve dhe pagesat realizohen vetëm për punët e përfunduara.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
11	Investimet me Kapital e	Kryetari, duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve do t'i raportojnë Departamentit të Prokurimit për çdo ndryshim nga termat dhe kushtet e kontratës dhe se çdo ndryshim do të bëhet vetëm pas aprovimit të marrë nga Zyra e Prokurimit dhe Zyrtarit Kryesor Administrativ.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
12	Investimet me Kapital e	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në mënyrë që kontratat të nënshkruhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fonde që sigurojnë ekzekutimin e tyre.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar

13	Investimet me Kapital e	Kryetari, duhet të sigurojë se bëhen planifikime të sakta dhe se të gjitha pagesat e projekteve bëhen sipas kodeve të aprovuara me ligjin e buxhetit apo sipas ri-destinimit të tyre komform dispozitave ligjore.	Nuk kemi identifikuar r çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
14	Investimet me Kapital e	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet e rasteve të identifikuar dhe sigurojë që planet dinamike për përfundimin e projekteve kapitale të përputhen me afatet reale të përfundimit të punëve.	Përkundër që nuk është zbatuar ky rekomandim është i përfshirë te rekomandimi B6.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar
15	Pasuritë	Kryetari, duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Në këtë aspekt duhet të sigurojë kontrolle në evidentimin e pasurisë jo kapitale si dhe të sigurojë funksionalizimin e plotë të sistemit e-pasuria për regjistrimin e pasurive nën 1,000€ dhe stokeve. Më tutje, të sigurojë se pas procesit të inventarizimit gjendja e inventarizuar krahasohet me regjistrin e përgjithshëm të pasurive, në mënyrë që diferencat e mundshme identifikohen dhe më pas pasqyrohen në regjistrat e pasurive.	E-Pasuria nuk është funksionalizuar ende.	Rekomandim i përsëritur Ref: B5
16	Paraja e gatshme/ekui valentë	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në trajtimin/menaxhimin e parasë së gatshme të komunës. Duhet siguruar se avanset mbyllen brenda afatit të përcaktuar kohor në pajtueshmëri me UA që e rregullon këtë çështje. Më tutje, rasti i përmendur, të rishikohet dhe të përmbyllet me procedurat e parapara	Nuk kemi identifikuar r çështje të ngjashme.	Rekomandim i zbatuar
17	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë. Në këtë aspekt të sigurojë se do t'i eliminojnë të gjitha gabimet në sistemin e tatimit në pronë si dhe sigurojë mekanizma efektiv për	Nuk janë marrë masa.	Rekomandim i përsëritur Ref: B6

		mbledhjen e të tyre, përfshirë edhe ushtrimin e masave ligjore për mbledhjen e tyre.		
18	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrollet për menaxhimin adekuat të këtyre llogarive të arkëtueshme, avancimin/sigurinë e programit me të cilin menaxhohen llogaritë. Duhet forcuar kontrollet ashtu që bizneset të ngarkohen me taksa në baza të rregullta vjetore në bazë të rregullores për taksa si dhe të sigurojë se merren të gjitha veprimet për arkëtimin e plotë të tyre.	Përkundër që nuk është zbatuar ky rekomandim është i përfshirë te rekomandimi B6.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar
19	Obligimet e papaguarara	Kryetari, duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të pagesave për të siguruar që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimit të faturës. Po ashtu të sigurojë se raportimi i obligimeve bëhet për çdo muaj në përputhje me kërkesat ligjore e cila duhet të përfshijë gjendjen e saktë të tyre.	Nuk janë marrë veprime	Rekomandim i përsëritur Ref:B7
20	Progresi i rekomandimeve	Kryetari, duhet të sigurojë se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioritetëve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka nevojë, të propozohen masat adekuate.		Rekomandim i mbyllur
21	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhim i rrezikut	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.	Komuna me rastin e hartimit të listës së rreziqeve kishte paraparë veprimet monitorues për mbikëqyrjen e aktiviteteve.	Rekomandim pjesërisht i përsëritur Ref: C2

Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1	PFV – B1	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime konkrete duhet të ndërmerren për të eliminuar gabimet në planifikimin/buxhetimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre. Gjithashtu, informatat lidhur me shpalosjen e pasurive duhet të jenë të plota me qëllim të prezantimit të tyre të plotë dhe të saktë në PFV.
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit – B2	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen komfor ligjit të buxhetit dhe kodeve ekonomike të përcaktuara sipas planit kontabël për kategori.
3	Pagat dhe mëditjet – A1	Kryetari, duhet të sigurojë se në procesin e rekrutimit ka emëruar komisione profesionale me qëllim që gjatë procesit të vlerësimit të respektohen plotësisht kriteret e kërkuara në mënyrë që të sigurohet që vetëm kandidatët meritator kanë fituar pozitat e punës.
4	Pagat dhe mëditjet – B3	Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me MSHV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.
5	Mallrat dhe Shërbimet – A2	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë me rastin e pranimin të propozimit për përmbartim, në rastet kur ka mos pajtime lënda të procedohet në gjykatë, njëherit duhet siguruar që për të gjitha rastet e kryerjes së punëve të përdoren procedurat e nevojshme të prokurimit si dhe të gjitha dokumentet duhet protokolluar pa përjashtim.
6	Mallrat dhe Shërbimet – A3	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtese të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, dhe në rastet e vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.
7	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se do të respektohen kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë. Gjithashtu, duhet siguruar që ndarja e detyrave dhe

	met - A4	përgjegjësi në aktivitetet e prokurimit të parandalojë mundësinë e konfliktit të interesit.
8	Subvencione dhe Transfere - C1	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi të bëhet në harmoni të plotë me rregulloren për subvencione dhe çdo shmangie nga kjo rregullore të analizohet dhe gabimet të korrigjohen. Marrëveshjet të hartohen para shpërndarjes së mjeteve të përfituesit, dhe të rriten kontrollet monitoruese pas shpërndarjes së subvencioneve.
9	Investimet me Kapital - A5	Kryetari duhet të sigurojë se aplikohen kushtet e kontratës, dhe procedimi i urdhërblereve bëhet vetëm pas nënshkrimit të kontratës.
10	Investimet me Kapital - B4	Kryetari, duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UOPP për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Proceset e prokurimit për projekte ekzekutive duhet të kryhen në fillim në mënyrë që t'i paraprijnë inicimit të prokurimit të projekteve tjera për punë.
11	Çështjet e përbashkëta IK&MS H - A6	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu, obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFP, për të shmangur pagesat me vendime përmbarimore dhe me kosto më të lartë.
12	Menaxhimi i Pasurive - B5	Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive duke mos e nënvlerësuar pasurinë në PFV, gjithashtu të sigurojë evidentimin e pasurisë jokapitale në sistemin e E-Pasurisë.
13	Të arkëtueshmet - B6	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e të arkëtueshme, duke siguruar procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre. Posedimi i një plani dhe programi operativ dhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve do ta rrisin nivelin e mbledhjes së borxheve.
14	Obligimet - B7	Kryetari, duhet të sigurojë komunikim efektiv në mes të drejtorive, për të mundësuar një raportim të plotë të obligimeve siç edhe kërkohet me rregullën financiare 02/2013. Po ashtu duhet siguruar kontrolle në ekzekutimin e pagesave, për të eliminuar vonesat në pagesën e faturave.
15	Raporti mi	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të organizatës, të sigurojë se është përcaktuar

	Menaxherial – C2	forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.
--	------------------	--

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
MUNICIPAL GLOGOC
Nr. 030-32672
01 Me datë 13.06.2019



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Zyra e kryetarit
Drenas, _____



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Glogocit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetar i Komunës,

z. Ramiz Lladrovci

Data: 13.06.2019,

